

# FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

## Programi 06370: Furnizimi me ujë dhe kanalizime

### Përmbajtja

PËRMBAJTJA.....	1
HYRJE .....	2
1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 06370 .....	2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT .....	10
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT .....	14
4. PROJEKTET E INVESTIMEVE TË PROGRAMIT .....	16
5. TË DHËNA MBI PROGRAMIN .....	17
6. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2023-2025 .....	19

## HYRJE

### 1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 06370

Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Ndërtimi dhe menaxhimi i sistemit të kolektorëve, kanaleve, tubacioneve dhe pompave për të larguar të gjitha ujërat e zeza (ujin e shiut, ujërat shtëpiakë dhe ujëra të tjerë të ndotur).		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
06370	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	<ul style="list-style-type: none"><li>• Administrim i problemeve të furnizimit me ujë;</li><li>• Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë;</li><li>• Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë;</li><li>• Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë;</li><li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.</li></ul> <ul style="list-style-type: none"><li>• Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza;</li><li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza.</li></ul>

#### I. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura

Ky shërbim realizohet nga ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Shkodër, sh.a:

- Rreth 23,320 familje janë të lidhur me rrjetin KUZ në Shkodër qytet + Nj.A 3,274 biznese në të gjithë Bashkinë janë të lidhura në sistemin e KUZ;
- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza në qytet është rreth 150 km;
- Rreth 77 % e numrit të përgjithshëm të banorëve të qytetit Shkodër janë të lidhur me rrjetin KUZ. Kryesisht janë të pa lidhur me rrjetin KUZ zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike
- Në Bashkinë Shkodër ka 2 impiante të pastrimit të ujërave të zeza: në Velipojë, dhe në Shirokë;
- Stacioni i Shirokës bën të mundur trajtimin e ujërave të përdorura që grumbullohen nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të zonës turistike Shirokë dhe i shkarkon në liqen, duke eliminuar kështu ndotjen e liqenit.
- Bashkia në programin e investimeve të vitit 2020, ka kryer investimet në ndërtimin dhe rikonstruksionin i rrjetit të KUZ dhe KUB në këto objekte: rruga "Ymer Prizreni" faza I-rë, rruga "Lek Dukagjini", Lagjia Nr. 1, Rruga "Rexhep Dizdari", "Rruga e Korpusit", Blloqe banimi Europa, Rruga "Safet Hoxha",

Rruga "Gjon Shllaku", rruga "Levizja e Postribes", rruga "Myzyrit", rruga "Mehmet Shpendi", rruga "1 Qershori", rruga "Paqes dhe e Beses Shqiptare", rruga "Ibrahim Rugova", rruga "Magjoni", rikonstruksion blloqe banimi "Lek Dukagjini" (ish vajguri), rruga «Degrand» dhe degëzime të rugëve «Marin Beçikemi» dhe «Pogej».

- Bashkia në programin e investimeve të vitit 2021, po realizon investimet në ndërtimin dhe rikontruksionin e rrjetit të KUZ dhe KUB.

<b>Nr.</b>	<b>Të përfunduara</b>	<b>KUB (ml)</b>	<b>KUZ (ml)</b>
1	Rikonstruksion rruga "Daniel Mozali" loti 2	300	
2	Rikonstruksion rruga e Dalmaces	350	340
3	Rikonstruksion rruga Zhasin Hakard	170	170
4	Rikonstruksion rruga Freskej	100	95
5	Rikonstruksion rruga Gjino Berri	190	185
6	Rik. i Rugës "Ymer Prizreni" faza II	82	80
7	Sistemim,asfaltim rruga Sektor Velipoje	120	
8	Rikonstruksion rruga Magjoni	270	
9	Rikonstruksion rruga Amadeo	180	
	<b>NE PROCES</b>		
10	Rikonstruksion Rugët e brendshme Shiroke: Rruga e Shtregullave.	196	
11	Sistemim asfaltim rruga e Drinit Bahcallek-	430	
12	Rikonstruksion Rruga "Muharrem Dragovoja"	150	160
13	Rikonstruksion Rruga "Ferrukej"	430	415
14	Rikonstruksion degëzim Rruga "Treni i Mallrave"	145	150
15	Rikonstruksion Rruga "Asdreni"	195	190
16	Rikonstruksion vazhdimi i Rugës "Bardhosh Dani" në lidhje me Rugën "Rrojej"	280	190
17	Rikonstruksion i Rugës "Milosao"	102	85
18	Rikonstruksion i Rugës pranë shkollës "Ali Laçej"	174	146
19	Rikonstruksion Rruga "Usta Meta "	334	315
20	Rikonstruksion degëzim Rruga "Besnik Ceka"	115	110
21	Rikonstruksion Rruga (degëzim) "At Zef Valentini"	270	253
22	Rikonstruksion Rruga "Milan Shuflaj"	438	430
23	Rikonstruksion Rruga "Qafa e Bishkazit"	355	340
24	Rikonstruksion Rruga "Don Nikollë Kaçorri"	175	182
25	Rikonstruksion i Bllokut të pallateve Rruga "Arkitekt Sinani"	120	90
26	Sistemim Asfaltim segmenti rrugor rruga "Skenderaj" dhe rruga "Haxhi Cafaj" Golem	400	
27	Rehabilitim i qendres së fshatit Grude e re, rruga "Kalimtari" dhe rruga Shkolla e re	350	
28	Sistemim Asfaltim rruge të brendshme fshati Hot i Ri	230	
29	Sistemim asfaltim rruga Dani në Bardhaj	400	
30	Sistemim,asfaltim,rruge të brendshme Dobraq (rruga Çeliku, Dinaj, Haxhi Zeneli)	620	

<b>31</b>	Sistemim Asfaltim Rruga "Maliq Idrizi" Shtoj i Ri faza e pare	350	
<b>32</b>	Sistemim - Asfaltim i rrugës Oblike – Pallate	120	
	<b>Total</b>	<b>8141</b>	<b>3926</b>

## **II. Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmytjet në zonat e banuara.**

Ky shërbim realizohet nga Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, sh.a:

- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza;
- Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve të KUB për qytetin është rreth 54 km. Rreth 37 km përbëhen nga tubacione të mbyllura dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura;
- Sistemi kryesor i drenazimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.
- Gjatë vitit 2020-2021 është punuar në të gjitha rrugët kryesore, si më poshtë:
- Pastrim kanali Tepe
- Pastrim kanali Kiras
- Pastrim çbllokim kolektori Unaza madhe lindore
- Pastrim çbllokim kolektori Unaza madhe Perëndimore
- Pastrim çbllokim kolektori Unaza vogël lindore
- Pastrim çbllokim kolektori Unaza vogël Perëndimore
- Pastrim çbllokim kolektori Rus- Xhabije
- Pastrim çbllokim kolektori Dugajt e reja – Stom Golem
- Pastrim çbllokim kolektori Ura Kirasit- Kiras
- Pastrim kuneta Bulevardi Zogu i I-rë.
- Pastrim kanali Velipojë Plazh
- Përveç kanaleve të mëdha kulluese, gjithashtu ka vazhduar puna rutinë në pastrimin e kunetave dhe kanaleve në rrugica të lagjeve të ndryshme të qytetit.
- Riparime dhe vendosje gradelash dhe pusetash
- Meremetim puseta Unaza e madhe
- Riparim linja e KUB, rruga “Marin Barleti”, “Lek Dukagjini“, “Arra e madhe“
- Zëvendësimin e gradelave dhe riparim pusetash të dëmtuara në të gjithë qytetin.
- Punime civile:
- Dezinfektim i ambienteve dhe hapësirave të UKSH
- Pastrim territori Ambiente e UKSH, Stacionet e pompimit, Kaptazhet dhe rezervuaret.
- Transferta prej 15,000 mijë parashikuar në buxhetin e Bashkisë i është kaluar Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, sh.a

### III. Furnizimi me ujë të pijshëm realizohet nga Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, sh.a:

Më poshtë jepet informacion mbi shërbimin që ofrojmë në qytet dhe në njësitë administrative.

- 29,301 familje (76% në Shkodër qytet + Nj.A) furnizohen me ujë të pijshëm;
- 3,284 biznese në të gjithë Bashkinë furnizohen me ujë nga ujësjiellësi;
- Gjatë stinës së dimrit, sasia e prodhuar e ujit është 650 litra/ sek kurse gjatë stinës së verës, sasia e prodhuar e ujit është 850 litra/sek;
- Rreth 78% e banorëve të qytetit Shkodër dhe 23% e banorëve të Nj.A furnizohen me ujë të pijshëm;
- Furnizimi me ujë i qytetit të Shkodrës kryhet me ngritje mekanike nga 10 pushtimet që janë në funksion dhe nga 2 stacione pompimi që ndodhen në Dobraq. Zonat që mbulohen nga ky shërbim janë:
  - o Qyteti Shkodër
  - o Një pjesë e Komunës Rrethina që merr furnizim me ujë nga linjat kryesore të transmetimit të ujit që shtrihen nga Stacioni Pompave në Dobraq direkt për në sistemin shpërndarës
  - o Lagjen Bahçallëk me një pjesë të Komunës Bërdicë (zona e Harkut të Bërdicës)

#### Sfidat:

Nevojat për ndërhyrje me investime për përmirësimin e sistemit ujësjiellës janë shumë të mëdha si në rrjetin shpërndarës të qytetit, ashtu edhe në ndërtimin e rrjetit për zonat informale, zonat rurale dhe në linjat kryesore.

- **Me fondet e vetë Bashkisë:** Rikonstruksion e rrjetit kryesor të ujësjiellësit dhe ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjiellësit në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re (faza e dytë dhe e tretë).

Njëkohësisht në çdo investim që realizohet me fondin e investimit në programin e përmirësimit të infrastrukturës së rrugëve, pjesë përbërëse e këtyre investimeve është edhe rikonstruksioni i plotë, ose ndërtimi (kur mungon tërësisht) i rrjetit të ujit të pijshëm.
- **Këshilli i Qarkut në bashkëpunim me qeverinë Shqiptare:** Ndërtim i Ujësjiellësit në fshatin Muriqan, Bashkia Shkodër. Në këtë kuadër Ndërtimi i Ujësjiellësit në fshatin Muriqan, si pjesë e Bashkisë Shkodër në Njësinë Administrative Ana e Malit, Qarkut Shkodër konsiderohet një ndër prioritetet e Bashkisë Shkodër për përmirësimin e jetës në komunitet. Zona e cila është parashikuar të përfitojë nga Ndërtimi i Ujësjiellësit në fshatin Muriqan, Bashkia Shkodër ndodhet rreth 16 km larg nga qyteti i Shkodrës dhe nga ky investim përfiton një komunitet prej 1000 banorësh. Përmes këtij investimi, synohet që të ndryshohet jetesa banorëve, do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik-social të zonës.

- **Me fondet e donatorëve:** Programi i performancës dhe investimeve në sektorin Ujësjetës – Kanalizime, me bashkëpunim financiar të qeverisë Gjermane, Bashkimit Europian dhe SECO. Ky projekt do të financojë për një periudhë afatmesme:
  - A. Rrjet të ri të ujit të pijshëm:
    1. Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në zonën Dobraç duke përfshirë edhe lagjen Golem. Theksojmë se banorët e zonës së Dobraçit kanë marrë ujë të pijshëm në tubacionet e dërgimit nga qyteti i Shkodrës, duke e dëmtuar nga ndërhyrjet e paligjshme. Kjo zonë paraqet rreth 30-40% të humbjeve në rrjet.
    2. Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në lagjen Mark Lulaj, zona nga Fermentimi që shtrihet pas shinave të trenit deri në Tepe.
    3. Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në zonat e Livadeve, duke përfshirë edhe lagjen Kiras
  - B. Rrjet të ri të kanalizimeve të ujërave të zeza
    1. Zona Dobraç përfshirë lagjen Golem
    2. Lagja “Mark Lulaj” që shtrihet pas shinave të trenit deri në Tepe
    3. Zona e Livadeve përfshirë lagjen Kiras
    4. Ndërtimi i impiantit të ujërave të ndotura për qytetin e Shkodrës, në Zues
    5. Përfshirja e lagjes Bahçallek për shkarkimin e ujërave të zeza në kolektorin e qytetit
    6. Rikonstruksioni i stacionit dhe linjat e dërgimit KESON.

Tabela 1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

**PBA 2023-2025**

Raport		Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike						
Bashkia Shkoder		Institucioni-						
Programi		6370	Furnizimi me ujë					
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Pritshëm	Plani	Plani	Plani
<b>Paga dhe Sigurime</b>								
Paga	600	-	-	-	-	-	-	-
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	-	-	-	-	-	-	-
<b>Korente</b>								
Mallra dhe Shërbime	602	-	-	61	61	-	-	-
Subvencion	603	10,000	-	-	-	-	-	-
Transferta të Brendshme	604	14,710	13,998	16,002	1,002	15,000	15,000	15,000
Transferta të Jashtme	605	-	-	-	-	-	-	-
Transferta për Familje & Individë	606	-	-	-	-	-	-	-
<b>Shpenzime Kapitale</b>								
Aktive të Paprekshme	230	-	-	-	-	-	-	-
Aktive të Prekshme	231	8,585	9,016	40,415	40,415	22,027	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>33,295</b>	<b>23,014</b>	<b>56,478</b>	<b>41,478</b>	<b>37,027</b>	<b>15,000</b>	<b>15,000</b>



## **Komente**

**Programi 6370: Furnizimi me ujë dhe kanalizime,** ka si burim financimi burimet e veta. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga transferta e pakushtëzuar për investimin e furnizimit me ujë për komunitetin.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet korente me rreth:

- Për vitin 2024 dhe 2025 kemi vetëm shpenzime korente
- Për vitin 2023 kemi 40.5% shpenzime korente dhe 59.5% shpenzime kapitale

## 2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

<b>POLITIKA E PROGRAMIT</b>					
<b>Programi Buxhetor Afatmesëm</b>		<b>2023-2025</b>			
<b>Programi</b>	<b>6370</b>	<b>Furnizimi me ujë dhe kanalizime</b>			
<b>Përshkrimi i Programit</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim i problemeve të furnizimit me ujë;</li> <li>• Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, crnimin dhe kontrollet e sasisë;</li> <li>• Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë;</li> <li>• Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë;</li> <li>• Grante, hua ose financime për të rimbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.</li> <li>• Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza;</li> <li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza.</li> </ul>					
<b>1</b>	<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	<p>I.Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. II.Rritja e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit. III.Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre . IV.Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara;</p>			
Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi		<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
Rritja e mbulimit me shërbim : % e popullsisë që mbulohet nga shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza/ndotura		24%	24%	24%	24%
Rritja e mbulimit me shërbim : % e popullsisë që mbulohet me shërbime sanitare / kanalizimeve të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha)		49%	47%	48%	50%
Efijencia e shërbimit / mbulimi koston së shërbimit nga tarifa - Mbulimi I koston nga tarifa e shërbimit (Raporti i të ardhurave nga tarifa kundrejt kostove (vetem O & M jo investime, pra jo kosto totale (në %)		133%	126%	126%	127%

	Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit - Buxheti për menaxhimin e kanalizimeve sanitare (m3 ujëra të zeza të menaxhuara) (Mijë Lekë për m3 ujëra të zeza (kosto operative dhe mirëmbajtje plus investime)	0.208	0.209	0.211	0.238
<b>1.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Sasia e ujit të shkarkuar në sistemin e përunimit të ujërave të ndotur - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës	40%	0%	0%	0%
	Rritja e mbulimit me shërbim : % e popullsisë që mbulohet nga shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza/ndotura	24%	24%	24%	24%
	Rritja e mbulimit me shërbim : % e popullsisë që mbulohet me shërbime sanitare / kanalizimeve të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha)	49%	47%	48%	50%
	Eficienca e shërbimit / mbulimi koston së shërbimit nga tarifa - Mbulimi i koston nga tarifa e shërbimit (Raporti I të ardhurave nga tarifa kundrejt kostove (vetem O & M jo investime, pra jo kosto totale (në %)	133%	126%	126%	127%
	Përmirësimi i menaxhimit të tarifave të shërbimit të kanalizimeve sanitare: Raporti shuma totale e faturuar për shërbimin kundrejt shumës së arkëtuar nga klientët (Raporti në %).	139%	100%	100%	100%
	Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit - Buxheti për menaxhimin e kanalizimeve sanitare (m3 ujëra të zeza të menaxhuara) (Mijë Lekë për m3 ujëra të zeza (kosto operative dhe mirëmbajtje plus investime)	0.208	0.209	0.211	0.238
<b>1.2.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimit të kanalizimeve të ujërave të shiut - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës	7%	0%	0%	0%
<b>2</b>	<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	I.Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve. II.Rritja e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit. III.Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre . IV. Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm;			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>

	Rritja e mbulimit me shërbim e ujit të pijshëm: Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	60%	61%	62%	65%
	Kohëzgjatja e ofrimit me ujë pijshëm në ditë: Orë ujë në ditë	22	22.5	22.5	23
	Eficienca e shërbimit / mbulimi kostos së shërbimit nga tarifa - Rritja e efijencës financiare të menaxhimit të shërbimit. Mbulimi i kostove nga tarifa e shërbimi. Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzimeve Operative dhe mirëmbajtjes (në %)	119%	119%	118%	100%
<b>2.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit dhe njësisve administrative të Bashkisë Shkodër.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Sasia e ujit të faturuar (/000m <sup>3</sup> ) /ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar	4.00%	0.69%	4.43%	-0.77%
	Humbjet (/000m <sup>3</sup> ) /ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar	-27%	-13%	-11%	17%
	Sasia e prodhimit të ujit Qytet (Litër/sek)	330	306	306	307
	Rritja e mbulimit me shërbim e ujit të pijshëm: Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	60%	61%	62%	65%
	Kohëzgjatja e ofrimit me ujë pijshëm në ditë: Orë ujë në ditë	22	22.5	22.5	23
<b>2.2.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Mirë administrimi i shërbimit të furnizimit me ujë.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Eficienca e shërbimit / mbulimi kostos së shërbimit nga tarifa - Rritja e efijencës financiare të menaxhimit të shërbimit. Mbulimi i kostove nga tarifa e shërbimi. Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzimeve Operative dhe mirëmbajtjes (në %)	119%	119%	118%	100%
	Eficienca e shërbimit / mbulimi kostos së shërbimit nga tarifa - Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (plus investime dhe amortizimi) (në %)	81%	81%	81%	70%
	Përmirësimi i menaxhimit të tarifave të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve: Raporti shuma totale e faturuar për shërbimin kundrejt shumës së arkëtuar nga klientët (Raporti në %).	125%	100%	100%	100%
	Rikonstruksion i stacionit të vjetër të ujësjellësit në Dobraq. Ndërtim rrjeti te KUZ ne Dobraq. ( banorë përfitues)	7,000	7,000	7,000	7,000
	Numri i banorëve që furnizohen me ujë të pijshëm në fshatin Muriqan ( banorë përfitues)	1,000	1,000	1,000	1,000

<b>Kryetari i NJQV</b>		<b>Koordinatori i GMS</b>		<b>Drejtuesi i Programit</b>	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	Alfred Luleta
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:		Datë:		Datë:	

### 3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

<b>SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT</b>				
<b>Programi Buxhetor Afatmesëm</b>		<b>2023-2025</b>		
<b>Programi</b>		<b>06370</b>	<b>Furnizimi me ujë dhe kanalizime</b>	
<b>1.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë		
<b>1.1.A.</b>	<b>Produkti</b>	Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P06370.Q1.O1.A1.		
	Përshkrimi i Produktit:	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe pusetave; Mirëmbajtja e stacioneve të largimit të ujërave të ndotura		
	Njësia Matëse	m3		
		<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	450,000	450,000	450,000
	Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	0
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		#DIV/0!	#DIV/0!
	Ndryshimi në % i koston për njësi		#DIV/0!	#DIV/0!
<b>1.2.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë.		
<b>1.2.B.</b>	<b>Produkti</b>	Menaxhimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut (KUB)		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P06370.Q1.O2.A1.		
	Përshkrimi i Produktit:	Mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit të kanalizimit të ujërave të bardha për zonën e Bashkisë Shkodër. Evitim i problematikave që mund të çojnë në përmbytje të zonave të caktuara.		
	Njësia Matëse	numri i popullsisë me shërbime sanitare		
		<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	102,131	98,050	100,137
	Kosto totale (në mijë lekë)	15,000	15,000	15,000
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.1	0.2	0.1
	Ndryshimi në % i Sasisë		-4.0%	2.1%
	Ndryshimi në % i koston totale		0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston për njësi		4.2%	-2.1%

<b>2.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit dhe njësisve administrative të Bashkisë Shkodër; Mirë administrimi i shërbimit të furnizimit me ujë			
<b>2.1.A.</b>	<b>Produkti</b>	Furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Administrative			
	<i>Kodi i Projektit</i>	P06370.Q2.O1.A1 ; P06370.Q2.O2.A1 -A2			
	Përshkrimi i Produktit:	Sigurimi i gadishmërisë së furnizimit me ujë, nëpërmjet realizimit të remonteve të programuara, riparimit të defekteve dhe mirëmbajtjes së të gjithë agregateve punues			
	Njësia Matëse	numri i banorëve që marrin shërbim			
		<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	16,000	16,000	16,000	16,000
	Kosto totale (në mijë lekë)	22,027	22,027	0	0
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	1.4	1.4	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		0.0%	-100.0%	#DIV/0!
	Ndryshimi në % i koston për njësi		0.0%	-100.0%	#DIV/0!
<b>Kryetari i NJQV</b>		<b>Koordinatori i GMS</b>		<b>Drejtuesi i Programit</b>	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	Alfred Luleta
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:		Datë:		Datë:	

## 4. Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 4 Projektet e Investimeve të Programit

PBA 2023-2025  
(000 ALL)

### Projektet e Investimeve

<b>Bashkia Shkoder</b>	<b>Institucioni -</b>	
<b>Programi</b>	6370	<b>Furnizimi me ujë</b>

Kodi Projektit	Emri i Projektit	Kosto Totale e Projektit	Burimi i Financimit	Data Fillimit	Data Përfund.	2020	2021	2022	2023	2024	2025
						Fakti	Fakti	Buxheti	Plani	Plani	Plani
1410480	Rikonstruksion i rrjetit kryesor të ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në fshatrat	48,026	Fondet e veta	2019		8,585	9,016	18,388			
1410479	Rikonstruksion e rrjetit kryesor te ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit te brendshëm të ujësjellësit ne fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re (faza e dytë dhe e tretë)		Fondet e veta	2022				22,027	22,027		
	<b>Totali</b>	<b>48,026</b>				<b>8,585</b>	<b>9,016</b>	<b>40,415</b>	<b>22,027</b>	<b>0</b>	<b>0</b>



## 5. Të Dhëna mbi Programin

Tabela 5 Të dhënat e Programit

<b>Të Dhëna Bazë mbi Programin</b>						
	Të Përgjithshme	2018	2019	2020	2021	2022
<b>Të dhënat e programit/ Vitet</b>						
Të ardhurat e realizuara (në mijë lekë) nga tarifa e shërbimit të kanalizimeve		53,157	51,855	50,937	66,536	103,084
Të ardhurat e planifikuara (në mijë lekë) nga tarifa e shërbimit të kanalizimeve		73,509	54,228	53,493	53,224	74,292
Buxheti për shërbimin e menaxhimit të ujërave të zeza dhe kanalizimeve		81,802	83,592	81,366	79,346	93,494
<i>Shpenzime operative kanalizime (në mijë lekë)</i>		59,003	54,542	54,051	48,480	62,641
<i>Shpenzime operative impiantet e përpunimit (në mijë lekë)</i>		22,799	29,050	27,315	30,867	30,853
Sasia e ujit të shkarkuar rre sistemin e përpunimit të ujërave të ndotur		431,257	400,896	450,000	322,127	450,000
Popullsia që mbulohet nga shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza/ndotura		51,200	51,200	51,200	10,830	51,200
Popullsia me shërbime sanitare / kanalizimeve të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha)		88,052	88,880	93,939	93,310	102,131
Popullsia në zonën e shërbimit		206,101	208,618	209,542	208,618	210,182

Buxheti për shërbimin e menaxhimit të kanalizimeve të ujërave të shiut	7,262	15,640	14,710	13,998	15,000
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm (orë në ditë)	21.0	21.0	21.7	22.7	22.0
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm të realizuara në mijë Lekë.	243,940	237,739	230,121	232,080	373,819
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm të planifikuara në mijë Lekë.	340,299	259,275	247,903	244,628	298,589
Totali i shpenzimeve operative dhe mirëmbajtjes për shërbimin ujit të pijshëm në mijë Lekë.	278,734	278,926	270,176	286,463	313,002
Sasia e ujit të faturuar (/000m3)	4,161	4,045	3,960	3,922	4,079
Sasia e prodhuar e ujit (l/sek)	400	419	379	403	330
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (plus investime dhe amortizimi) (në mijë lekë)	425,533	425,725	417,264	420,733	460,090
Numri i familjeve në nevojë	15,858	1,983	1,984	1,985	1,986
Numri i banorëve që furnizohen me ujë të pijshëm në fshatin Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re,	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000
Humbjet ( në 000 m3 )	8,463	9,295	9,162	8,793	6,390
Numri i banorëve që përfitojnë shërbimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura në qytet. Ndërtim i impiantit të ri të ujërave të zeza në qytet. Vendosja e matësave të ujit në lagjet e qytetit.	113,955	115,215	115,907	118,042	125,171
Popullsia në zonën e shërbimit	206,101	208,618	209,542	208,618	210,182

## 6. Projektet e planifikuara për PBA 2023-2025

Tabela 6 Emërtimet e aktiviteve

Projekte të planifikuara			000/lekë
Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit	Buxheti 2023	Buxheti 2024	Buxheti 2025
P06370.Q1.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza.	-	-	-
P06370.Q1.O2.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB).	15,000	15,000	15,000
P06370.Q2.O1.A1. Furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Administrative.	-	-	-
P06370.Q2.O2.A1. Programi i performancës dhe investimeve në sektorin Ujësjellës-Kanalizime, me bashkëpunim financiar të qeverisë Gjermane, Bashkimit European dhe SECO.	-	-	-
P06370.Q2.O2.A2. Rikonstruksion i rrjetit kryesor të ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re (faza e dytë dhe e tretë).	22,027	-	-
<b>Totali</b>	<b>37,027</b>	<b>15,000</b>	<b>15,000</b>

<b>Nr. 1</b>	<b>P06370.Q1.O1.A1</b> Menaxhimi i sistemit te ujërave të zeza	<b>Funksioni 6:</b> Mbrojtja e mjedisit <b>N/Funksioni 063:</b> Furnizimi me ujë <b>Programi 06370:</b> Furnizimi me ujë				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Territori i juridiksionit i Bashkisë Shkodër mbulohet me shërbimin e kanalizimeve në nivelin 45%. Shërbimi i kanalizimeve ofrohet për pjesën më të madhe të qytetit dhe për zonën e plazhit në Velipojë. Gjendja e aseteve në operim nga UK Shkoder për sektorin e kanalizimeve, paraqitet si më poshtë:</p> <p><b>I – Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza për qytetin Shkodër</b> Ky sistem përbëhet nga: - Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit, i cili përbëhet prej rreth 150 km tubacione të dimensioneve të ndryshme, me material betoni dhe plastik, dhe rreth 10 000 puseta. - Stacioni i pompave, i cili ndodhet në hyrje të qytetit (Pazar) i cili është rikonstruktuar. Ky stacion bën të mundur pompimin e ujërave të zeza dhe ngritjen e tyre në kuotën e kolektorit shkarkues. Nëpërmjet këtij kolektori shkarkues, me tubacion betoni Ø 1000 mm ujërat e zeza derdhen në lumin Drin. - Pika e shkarkimit të ujërave të zeza, ndodhet në krah të djathtë të hyrjes së urës së Bahçallekut, në lumin Drin. Krahas saj shkarkim tjetër (emergjence) i ujërave të zeza bëhet në lumin Buna, nëpërmjet një kanali me tubacion plastik Ø 800 mm, i cili është rikonstruktuar plotësisht. Ky kanal fillon nga stacioni i pompave për në lumin Buna pranë urës së vjetër.</p> <p>Në kuadër të investimeve të realizuar nga Bashkia në programin e investimeve të vitit 2020, si pjesë e investimit në infrastrukturë është kryer rikonstruksioni i rrjetit të KUZ në këto objekte: rruga "Ymer Prizreni", rruga "Lek Dukagjini", Lagjia Nr. 1, Rruga "Rexhep Dizdari", "Rruga e Korpusit", Bllaqe banimi Europa, Rruga "Safet Hoxha", Rruga "Gjon Shllaku", rruga "Levizja e Postribes", rruga "Myzyrit", rruga "Mehmet Shpendi", rruga "1 Qershori", rruga "Paqes dhe e Beses Shqiptare", rruga "Ibrahim Rugova", rruga "Magjoni", rikonstruksion bllaqe banimi "Lek Dukagjini" (ish vajguri), rruga «Degrand» dhe degëzime të rrugëve «Marin Beçikemi» dhe «Pogej».</p> <p><b>II - Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Shirokë, i cili përfshin:</b> - Stacioni i Shirokës bën të mundur trajtimin e ujërave të përdorura që grumbullohen nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të zonës turistike Shirokë dhe i shkarkon në liqen, duke eliminuar kështu ndotjen e liqenit.</p> <p><b>III - Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Velipojë.</b> Nga Maji i viti 2017 ITUP Velipojë operohet nga stafi i UK Shkodër. Pavarësisht mangësive dhe vështirësive të konstatuara që në momentin e marrjes në dorëzim, gjatë vitit 2020 është punuar intensivisht për operimin dhe funksionimin normal të tij. Është punuar në pastrimin e kolektoreve kryesore K1, K2 dhe K3 komplet, kanalizime ujërave të përdorura të rrugëve të ndryshme të qytetit.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetet e grumbullimit të ujërave të zeza; Rritja e përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin e grumbullimit të ujërave të zeza, i cili në rastin e zonës së Shirokës dhe të Velipojës, është i lidhur me një impiant përpunimi të këtyre ujërave të ndotura.						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe pusetave; Mirëmbajtja e stacioneve të largimit të ujërave të ndotura; Mbulimi me shërbimin e KUZ nga UK Shkodër brenda zonave nën administrim në qytet dhe Nj.A; Lidhja e abonentëve (familjarë dhe biznes) me kolektorët e rinj të ndërtuar në rrugët dhe bllaqet e banimit; Ndërtimi i rrjetit të ri KUZ si pjesë integrale e projekteve të programit të infrastrukturës rrugore për Buxhetin 2021-2022 të Bashkisë Shkodër.						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
Përmirësim i gjendjes ekzistuese të rrjetit KUZ dhe funksionimi normal i tij; Zgjerimi i rrjetit me KUZ i zonave urbane nga investimeve të parashikuara në buxhetin e Bashkisë Shkodër; Rritja e numrit të përfituesve nga shërbimi.						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Drejtoria e shërbimeve publike dhe Infrastrukturës, Sektori i planifikimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës. Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Shkoder Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve			Bashkia Shkodër Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Shkodër Komuniteti			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023 - 2025</b>	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferta	Kapitale
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë viteve 2023 – 2025		<p><b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Ujësjellës- Kanalizime, Shkodër sha.</p> <p><b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër</p>				

<p><b>Nr.2</b></p>	<p><b>P06370.Q1.O2.A1</b></p> <p>Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB)</p>	<p><b>Funksioni 5:</b> Mbrojtja e mjedisit  <b>N/Funksioni 063:</b> Furnizimi me ujë  <b>Llojet e programit: 06370:</b> Furnizimi me ujë</p>
<p><b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b></p>		
<p><b>i. Situata</b></p>		
<p>Gjendja aktuale e sistemi i kanalizimit të ujërave të bardha (KUB):  Sistemi i kanalizimit të ujërave të bardha (shiut), u ndërtua fillimisht si një sistem i veçantë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të përdorura. Shkodra ka një sistem largimi të ujërave të shiut sipas një sistemi kanalesh të hapura, tombino dhe tubacione ku pjesa më e madhe e ujit të shiut shkarkohet me gravitet në Liqenin e Shkodrës. Disa zona, duke përfshirë edhe zonën industriale, shkarkohen në lumin Kir.</p> <p>Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve për qytetin e Shkodrës është rreth 54 km, nga të cilat, rreth 37 km përbëhet nga tubacione të mbyllura betoni e plastike dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura. Kanalet e hapura kanë nevojë për pastrime të herëpashershme, për të siguruar një gjendje të mirë të tyre nga ana hidraulike. Për të ardhmen duhet të mendohet investimi në mbulimin e tyre, pasi gjendja aktuale e tyre është burim hedhjeje e mbeturina inerte dhe të llojeve të tjera nga persona të papërgjegjshëm, duke u shndërruar në rrezik shëndetësor për komunitetet përreth tyre. Pjesa tjetër e kanalizimeve përbëhet nga kanale në gjendje të amortizuara, me karakteristika përcjellje prurje jo të mira. Përveç kësaj, ka dhe shumë kilometra me kanale të vogla kullimi, të cilat kanë nevojë për ridimensionim.</p> <p>Problematikë tjetër e mprehtë, janë lidhjet e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të përdorura me kanalizimet e ujërave të shiut, që janë bërë ndër vite si rrjedhojë e mungesës së rrjeteve të kanalizimit, apo në mënyrë të njëanshme nga banorët. Këto lidhje, përbëjnë rrezik të dukshëm, sidomos nga përmbytjet gjatë kohës së reshjeve. Vjedhja e kapakëve të puseta dhe gradelave prej material gize, krijojnë probleme në qarkullim dhe shoqërohet me hedhje të mbeturinave të cilat çojnë në bllokim dhe mosfunksionim të tyre.</p> <p>Puna e deritanishme tregon për probleme të shumta dhe për nevoja emergjente ndërhyrjeje edhe në sektorin e KUB për zonat rurale.</p> <p>Aktiviteti punues i sektorit KUB për vitin 2020-2021  Për vitin 2021 janë hartuar plane pune për mirëmbajtjen rutinë të pastrimit të kanaleve të ujërave të shiut, gjithashtu janë realizuar edhe ndërhyrje të paplanifikuara sipas situatave kritike që janë krijuar dhe që rrezikonin përmbytje të zonave të caktuara. Kanalet kryesore të kullimit kanë nevojë për ndërhyrje në pastrimin e tyre me makineri të mëdha, për heqjen e dherave, largimin e mbeturinave dhe prerjen e shkurreve dhe bimësisë përgjatë tyre.  Gjatë vitit 2020-2021 është punuar në të gjitha rrugët kryesore, si më poshte:</p> <p><b>Pastrim kolektore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pastrim kolektori ne bulevardin Bujar Bishanaku</li> <li>• Pastrim kolektori ne bulavardin Mehmet Pashe Plaku</li> <li>• Pastrim ç`bllokim kolektori Unaza madhe lindore</li> <li>• Pastrim ç`bllokim kolektori Bulevardin Skenderbeg</li> <li>•</li> <li>• Pastrim kanale te hapura kryesore</li> <li>•</li> <li>• Pastrim Kanal kryesore Ajasem</li> <li>• Pastrim Kanal kryesore ne rrugen Besnuk Ceka</li> <li>• Pastrim Kanal kryesore ne rrugen Dracin</li> <li>• Pastrim Kanal kryesore ne rrugen Vellezerit Frasheri</li> <li>•</li> <li>• Pastrim kanale te hapura te vogla</li> <li>•</li> <li>• Pastrim Kanal kryesore Hoxha Tasim</li> <li>• Pastrim ne rrugen At Zef Valentini</li> <li>• Pastrim ne rrugen Valentin Saraci</li> <li>•</li> </ul> <p>Gjatë vitit 2020-2021 Bashkia Shkodër ka investuar shumë në rikonstruksion të rrjetit KUB, jo vetëm në rrugët e qytetit të Shkodrës, por është në zonat rurale. Investimet kryesore të bëra në rrjeti KUB janë si më poshtë; rruga „Ndre Mjeda“ rruga „Koplikeve“, rruga „Ernest Koliqi“, rruga „Ymer Prizreni“, blloqe palatesh degëzim bulevardi Mehmet Pashe Plaku „Lek Dukagjini“, „Shate shaljanet“, rruga „Rexhep Dizdari“, rruga „Safet Hoxha“, rruga „Gjon Shllaku“, rruga „Mehmet Shpendi“, „Bahçallek“, rruga „1 Qershori“, rruga Ibrahim Rugova“, rruga Magjoni“, rruga Paqja dhe Besa Shqiptare“, Velipoje, Pentar, si degëzime të rrugeve, „At Gjergj Fishta“, „Marin Beçikemi“ dhe „Pogej“ dhe të tjera rrugë në peoces.</p> <p>Përveç kanaleve të mëdha kulluese, gjithashtu ka vazhduar puna rutinë në pastrimin e kunetave dhe kanaleve në rrugica të lagjeve të ndryshme të qytetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Riparime dhe vendosje gradelash dhe puseta</li> <li>• Meremetim puseta Unaza e madhe</li> <li>• Riparim linja e KUB , rruga „Marin Barleti“, „Lek Dukagjini“, „Arra e madhe“</li> <li>• Zëvendësimin e gradelave dhe riparim puseta të dëmtuara në të gjithë qytetin.</li> <li>• Punime civile:</li> </ul>		

- Pastrim territori Ambjente e UKSH, Stacionet e pompimit, Kaptazhet dhe rezervuarat.

#### **Kostot e aktivitetit punues të sektorit KUB**

Zërat kryesore të kostos për sektorin e KUB, paraqiten si më poshtë:

Përsa i përket pagave dhe sigurimeve shoqërore, llogaritjet për fondin e pagave, janë bërë mbi bazën e organikës së miratuar për vitin 2022 për sektorin e KUB dhe nivelit të pagës së përcaktuar, nga Këshilli i Administrimit i Ujësllës kanalizime Shkodër. Nevojat për bazë materiale, janë gjithashtu të larta dhe grupet kryesorë të artikujve për mbulimin me këtë shërbim të të gjithë zonës së shërbimit, janë si më poshtë:

1. Kapakë puseta dhe gradela
2. Naftë
3. Prodhime betoni
4. Materiale ndërtimi
5. Materiale për zyrë

Kapakë puseta dhe gradela, zë një pjesë të konsiderueshme, për arsye se përveç zëvendësimeve nga dëmtimet e tyre, duhet të bëhet mbahen në konsideratë edhe vjedhjet e shumta për këto produkte për arsye se ato tregtohen për skrap. Shqetësimi që krijon në qarkullimin e automjeteve dhe të këmbësorëve, na imponon ndërhyrjen e domosdoshme me zëvendësimin dhe vendosjen e kapakëve dhe gradela, në segmentet ku mungojnë.

Në funksion të mirëmbajtjes së rrjetit sektori i KUB ka në përdorim një mjet gërmues, një mjet transporti dhe një mjet zbllokues. Automjetet janë të rënda dhe kërkojnë konsum të madh naftë, pasi ato konsumojnë në ecje dhe gjithashtu për orë punë, gjatë pastrimit të kanaleve të hapura të cilat mbushen jo vetëm me mbeturina, por gjithashtu edhe nga bimësia që rritet në to, duke penguar rrjedhjen e lirë të ujërave.

Prodhimet e betonit dhe materialet e ndërtimit, kryesisht përdoren për zëvendësimet e kapakëve dhe soletave b/a, që mbulojnë shume puseta në blloqe të ndryshme. Gjithashtu riparimi i puseta të dëmtuara, ka nevojë për tulla, blloqe dhe materiale ndërtimi.

Bazuar edhe në nevojat në rritje për mbulimin dhe zgjidhjen e problematikave, të sektorit të kanalizimit të ujërave të bardha, edhe për zonat që shtrihen përtej kufinjve të vijës së verdhë të qytetit, shpenzimet e KUB janë rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe në bazë të rishikimit të kërkesave për këtë sektor, vlerësohet se niveli i parashikuar i shpenzimeve për vitin 2023 të jetë 15.000.000 lekë. Gjithashtu edhe parashikimet për shpenzimet operative të sektorit KUB për vitin 2023-2025, parashikohet të jenë të jenë të larta, kjo si rrjedhojë e rritjes së volumit të punëve dhe mbajtjes në gjendje të mirë të kanaleve të kullimit për evitimin e përmblyjeve të mundshme gjatë rreshjeve atmosferike. Sektori KUB vlerësohet nga UK Shkodër Sh.a, si një sektor, sa i rëndësishëm aq edhe delikat, sidomos në problematikën që krijon në stinët e pranverës, vjeshtës dhe dimrit ku reshjet e shumta që bien në qytetin tonë, krijojnë shpeshherë probleme deri në përmblyje. Tendencë në rritje e kostove të operimit për UK Shkodër, dhe vështirësitë financiare për mbulimin e shpenzimeve operative, si rrjedhojë e zgjerimit të zonës së shërbimit dhe marrjes në dorëzim të sistemeve të KUB për zonën e Velipojës, Bërdicës, etj të cilat gjithashtu kanë problematika të mbartura nga mungesa e mirëmbajtjes, apo investimeve në pjesën më të madhe të tyre, kërkojnë angazhim dhe përpjekje në nivele akoma më të larta.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza. Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.

#### **ii. Synimi i projektit**

Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjet kryesore për të evituar problematikën e ndryshme, përshtirë edhe uljen e mundësisë së përmblyjeve të qytetit.

#### **iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Mirëmbajtje e vazhdueshme e kanalizimeve të ujërave të bardha nga UK Shkodër brenda zonave nën administrim. Pastrimi i pusetave dhe gradelave shi mbajtëse, përfshirë edhe riparimin ose zëvendësimin e pusetave, kapakëve të dëmtuar ose të vjedhur. Pastrimi i kanaleve kryesore të kullimit dhe ndërhyrjet me makineri për heqjen e dherave, largimin e mbeturinave dhe prerjen e shkurreve dhe bimësisë përgjatë tyre. Ndërtimi i rrjetit të ri KUB si pjesë integrale e projekteve të programit të infrastrukturës rrugore për Buxhetin 2022 të Bashkisë Shkodër

#### **b) Rezultatet që prisni**

Mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit të kanalizimit të ujërave të bardha për zonën e Bashkisë Shkodër. Evitim i problematikave që mund të çojnë në përmblyje të zonave të caktuara. Rritja e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit për qytetarët e bashkisë Shkodër, si rezultat i tarifave të reja të miratuara së bashku me investimet kapitale në rrjetin KUB.

#### **c) Aktorët e mundshëm**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukture, Sektori i planifikimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës. Sh.a. Ujësllës Kanalizime Shkodër. Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve.

#### **d) Kontributet e mundshme në projekt**

Bashkia Shkodër  
Komuniteti

<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>	Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
		Paga, sig	Operati	Transferi	Kapitale

			ve	me		
<b>A.1</b>	Transferim për mbulimin e kostove operative dhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.	<b>15,000</b>		15,000		
	<b>Shuma totale</b>	<b>15,000</b>		<b>15,000</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga, sig	Operative	Transferime	Kapitale
<b>A.1</b>	Transferim për mbulimin e kostove operative dhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.	<b>15,000</b>		15,000		
	<b>Shuma totale</b>	<b>15,000</b>		<b>15,000</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2025</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga, sig	Operative	Transferime	Kapitale
<b>A.1</b>	Transferim për mbulimin e kostove operative dhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.	<b>15,000</b>		15,000		
	<b>Shuma totale</b>	<b>15,000</b>		<b>15,000</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë viteve 2023 – 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Ujësjellës Kanalizime Shkodër sha. <b>Institucioni likuidues:</b> Bashkia Shkodër				

Nr.3	<b>P06370.Q2.O1.A1</b> Furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Administrative	<b>Funksioni 6:</b> Strehimi dhe komoditeti i komunitetit <b>N/Funksioni 063:</b> Furnizimi me ujë <b>Llojet e programit: 06370:</b> Furnizimi me ujë
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Territori i juridiksionit i Bashkisë Shkodër mbulohet me shërbimin e furnizimit me uje në nivelin 56%. Shërbimi i furnizimit me uje ofrohet për zonen urbane dhe rurale. Situata e furnizimit me uje ne qytet paraqitet e qendrushme, ndersa ne zonat rurale mbulimi me kete sherbim eshte me i ulet. Që nga viti 2016, kur u morën në dorëzim sistemet e furnizimit me ujë të zonës rurale, janë bërë përpjekje për përmirësimin e furnizimit me ujë të pishëm të popullatës së këtyre njësive administrative. Në pamundësi të realizimit të investimeve kapitale, aktivitetet përmirësuese janë bazuar kryesisht në mirëmbajtje rutinë, si dhe në hartimin e grafikeve të operimit të pompave, për të optimizuar furnizimin me ujë të banoreve të këtyre njësive administrative. Përveçse zona e shërbimit është zgjeruar shume, gjendja e sistemeve të ujësjellesave të fshatrave paraqitet shume e amortizuar dhe ka rezultuar në:</p> <p>Rritjen e kostove te operim mirembajtjes.</p> <p>Vështirësi në realizimin epunimeve të mirëmbajtjes, si rrjedhojë e faktit se objektet kryesore në pjesën më të madhe janë në prona private pa rrugë hyrëse për shërbime mirëmbajtje e zëvendësim elektropompa e transformatorë.</p> <p>Djegje te shpeshta te makinerive punuese, si rrjedhoje e furnizimit me energji elektrike jashte standarteve teknike me shume luhatje tensioni.</p> <p>Kohezgjatja e ulët e furnizimit me uje te zones rurale, duke ndikuar negativisht ne cilesine e sherbimit qe i ofrohet abonenteve te ketyre zonave.</p> <p>Mangësi në parashikimin e bazës materiale për operim mirëmbajtjen e këtyre sistemeve si rrjedhojë e nivelit të lartë të amortizimit të tyre dhe mungesës totale të azhurnimeve me dokumentacione teknike për llojin e materialeve të instaluar dhe dimensioneve.</p> <p>Gjithë aktiviteti shoqërohet me kosto shume te larta financiare, te cilat eshte e veshtire te perballohen me te ardhurat e e veta nga UK Shkoder, pa u mbeshtetur me financim nga qeveria. Shpenzimet e energjise elektrike per stacionet e pompimit te zonave rurale, per vitin 2021 vleresohet te jene rreth 25.000.000 lek, ky fakt do te rendoje me teper shoqerine UK me shpenzimet e energjise elektrike per te cilet kerkohej subvencion ne vleren 25.000.000 lek.</p> <p>Ndersa situata e furnizimit me uje te qytetit paraqitet si me poshte:</p> <p>Furnizimi me ujë i qytetit të Shkodrës kryhet me ngritje mekanike nga 10 pus-shpimet që janë në funksion dhe nga 2 stacione pompimi që ndodhen në Dobraq. Zonat qe mbulohen nga ky shërbim janë:</p> <p>Qyteti Shkodër</p> <p>Një pjesë e Komunës Rrethina që merr furnizim me ujë nga linjat kryesore të transmetimit të ujit që shtrihen nga Stacioni Pompave në Dobraq direkt për në sistemin shpërndarës</p> <p>Lagjen Bahçallëk me një pjesë të Komunës Bërdicë (zona e Harkut të Bërdicës)</p> <p>Norma standarte e furnizimit me ujë është 150 litër/për një frymë/në dit. Prodhimi në stinën e dimrit është rreth 650 l/s, ndërsa në stinën e verës shkon rreth 850 l/s.</p> <p>Niveli i humbjeve të ujit është i lartë dhe është rrjedhojë e amortizimit te rrjetit, dëmtimet nga ndërtimet, ndërhyrjet e shumta të paligjshme nga banorët e ish Komunës Rrethina në linjat kryesore, zgjatja e tyre nëpër zona të banuara që arrijnë deri ne Vrakë, etj. Zgjatja pa kriter e linjave të hapura private në zonat periferike shkakton prishjen e regjimit të furnizimit me ujë te qytetit, ku është investuar edhe në shtrimin e linjave të ujësjellësit. Gjatë vitit 2020 mund të përmendim investime të bëra në shtrim linja ujësjellësi në rrugën; Ymer Prizreni, Lek Dukagjini, «Imzot Zef Simoni», Blloqe banimi Europa, Safet Hoxha, Gjon Shllaku, Myzyrit, «1 Qershori», degëzim i rrugës «At Shtjefën Gjecovi». Të gjitha këto ndërhyrje ndihmojnë në përmirësimin esherbimit të ofruar për klientet ekzistues.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
Garantimi i furnizimit me ujë të pishëm të popullatës pa ndërprerje. Rritja e aksesit të popullsisë urbane dhe rurale në furnizimin me ujë të pishëm të sigurtë.		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
Furnizimi pa ndërprerje i popullatës me ujë të pishëm. Mirëmbajtja e rrjetit të furnizimit me ujë të pishëm nga Ujësllës Kanalizime Shkodër brenda zonave nën administrim. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë nga UK Shkodër brenda zonave nën administrim, në shtrirje sa më të gjërë dhe me koston me efikase të mundshme. Ndërtimi i rrjetit të ri të furnizimit me ujë të pishëm si pjesë integrale e projekteve të programit të infrastrukturës rrugore për Buxhetin 2022 të Bashkisë Shkodër .		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		



Zgjerimi dhe përmirsimi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat urbane dhe rurale.						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Drejtoria e shërbimit publike dhe Infrastruktura, Sektori i mirembajtjes së infrastruktures Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve			Bashkia Shkodër Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023-2025</b>	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)</b> Gjatë viteve 2023 - 2025		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastruktura, Sektori i Planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastruktura. Ujësjetllës- Kanalizime Shkodër sh.a Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve				

#### P06370.Q2.O1.A2

Programi i performancës dhe investimeve në sektorin Ujësjetllës – Kanalizime , me bashkëpunim financiar të qeverisë Gjermane, Bashkimit European dhe SECO.

#### 01. Personat e Kontaktit

<b>Emri i propozuesit të projektit</b>	Bashkia e Shkodrës	<b>Firma e propozuesit të Projektit</b>	
<b>Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit</b>	Ujësjetllës Kanalizime Shkodër		
<b>Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia Shkodrës Ujësjetllës Kanalizime Shkodër	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia Shkodër

#### 02. Identifikimi i Idesë së Investimit

<b>Projekt Idea</b>	Programi i performancës dhe investimeve në sektorin Ujësjetllës – Kanalizime , me bashkëpunim financiar të qeverisë Gjermane, Bashkimit European dhe SECO.	Viti 2020
<b>Problemet për tu adresuar</b>	<p>Në Nentor të vitit 2019, Bashkia Shkodër firmosi procesverbalin për mbështetjen që agjensitë Bashkëpunimi Financiar Gjerman, Bashkimi European dhe SECO do të realizojnë në fazën e parë të mbështetjes në katër vitet e ardhshme, për Bashkinë Shkodër, UKSH Shkodër, në sistemin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve.</p> <p>Vlera e financimit dhe prioritarizimi i investimeve janë rrjedhojë e vlerësimit teknik që ekspertët e huaj kanë bërë gjatë këtij viti për UKSH Shkodër, indikatorët e performancës në rritje, dhe objektivat e vënë e nevojave prioritare për investime.</p> <p>Në Tetor të 2020 është arritur të perfundohet dhe dorëzohet Studimi i fizibilitetit, për këtë projekt investimesh kapitale.</p> <p>Komponenti i sektorit të ujësjetllës është pjesë e kësaj mbështetjeje dhe paraprakisht është përcaktuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komponenti i ujit (afërsisht 10 milion EURO)</li> <li>• Rehabilitimi i rrjetit të ujësjetllës në Qytetin e Shkodrës duke përfshirë krijimin e Zonave të Matura të Shërbimit (DMA) dhe lidhjeve në banesa në këto DMA; shtrirja e rrjetit të ujësjetllës në Dobraq; Sistemi SCADA, pajisjet O&amp;M.</li> </ul> <p>Kjo mbështetje përveç investimit, ka të bëjë me përgatitjen e projekteve të hollësishme dhe dokumenteve të tenderimit, mbështetjen e tenderit dhe kontraktimit, mbikëqyrjen e punimeve dhe furnizimeve, si dhe ofrimin e ndihmës gjatë periudhës së përgjegjësisë për defektet.</p>	

	<p>Kostot e mësipërme të investimit për projektin shërbimet e konsulencës mund të financohen nga një kredi zhvillimi në kushte të favorshme së bashku me fondet e granteve të dhëna nga EU IPA 2018, Qeveria gjermane e zvicerane.</p> <p>Kontributi shqiptar përfshin buxhetimin dhe rimbursimin e TVSH-së, si dhe sigurimin e tokës që duhet për ndërtim.</p> <p>Programi i përbahet treguesve të performancës të përdorura nga Njësia e Monitorimit dhe Vlerësimit pranë AKUM. Këta tregues të performancës përdoren gjithashtu nga rregullatori ERRU.</p> <p>Auditimet vjetore të performancës do të kryhen në përputhje me fazat kryesore dhe kushtet e mëposhtme shtesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Efikasiteti i arkëtimeve do të mbetet gjithmonë mbi 85%;</li> <li>• Shërbimet e ujësjellësit që shoqërohen pa të ardhura do të ulen më tej (mesatarja e luhatshmërisë për 12 muajt e fundit do të jetë më e ulët se mesatarja e luhatshmërisë për 12 muajt e mëparshëm);</li> <li>• Volumi i ujit në DMA-të e vendosura do të monitorohet vazhdimisht bazuar në konsumin e matur të ujit;</li> <li>• Furnizimi me ujë nuk do të bjerë mesatarisht nën 20 orë në ditë dhe do të rritet më tej;</li> <li>• Numri i stafit administrativ plus personeli i ujësjellësit për 1000 lidhjet aktive (konsumi &gt;0 m<sup>3</sup>) në sistemin e furnizimit me ujë do të ulët në 8 ose më pak;</li> <li>• Punimet që janë në zbatim e sipër dhe aktivet që kanë qenë mbuluar dhe do të mbulohen nga programet e tanishme ose të mëparshme të KfE-së duhet të përditësohen me bazë vjetore;</li> <li>• Ndërmarrja mbështet certifikimin e personelit dhe raporton tek AKUM në lidhje me përparimet që janë bërë për certifikimin e stafit.</li> </ul> <p>Financimi i këtij programi investimesh, bëhet në bashkëpunim mes Qeverisë Gjermane dhe Zvicerane, si dhe Bashkimit European.</p> <p>Ky program investimesh ka filluar në vitin 2020 dhe ka një kohëzgjatje 4-vjeçare. Gjatë zbatimit dhe në përfundim të tij, synohet të përmbushen objektivat e vendosur për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve ujësjellës dhe kanalizime në Bashkinë Shkodër.</p> <p>Si rrjedhojë e situatës së krijuar nga shpallja e pandemisë botërore Covid 19, është prekur edhe koha e fillimit të këtij projekti madhor për qytetin e Shkodrës.</p> <p><b>Ky projekt do të financojë:</b>  <b>Rrjet i ri i ujit të pijshëm:</b>  1.Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në zonen Dobraq duke përfshirë edhe lagjen Golem. Theksojmë se banorët e zonës së Dobraqit kanë marrë ujë të pijshëm në tubacionet e dergimit nga qyteti i Shkodrës, duke e dëmtuar nga ndërhyrjet e paligjshme. Kjo zonë paraqet rreth 30-40 % të humbjeve në rrjet.  2.Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në lagjen Mark Lulaj, zona nga Fermentimi që shtrihet pas shinave të trenit deri në Tepe.  3.Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në zona e Livadeve, duke përfshirë edhe lagjen Kiras</p> <p><b>Rrjet i ri i Kanalizimeve të ujërave të zeza</b>  1.Zona Dobraq përfshirë lagjen Golem  2.Lagjja "Mark Lulaj" që shtrihet pas shinave të trenit deri në Tepe  3.Zona e Livadeve përfshirë lagjen Kiras  4.Ndërtimi i impiantit të ujërave të ndotura për qytetin e Shkodrës, në Zues  5.Përshirja e lagjes Bahçallek për shkarkimin e ujërave të zeza në kolektorin e qytetit  6. Rikonstrukcioni i stacionit dhe linjat e dergimit KESON.</p> <p>Aktualisht po punohet për dizënjimin e projekteve teknike të zbatimit.</p>
<b>Emri i Programit</b>	Programi i Performancës dhe Investimeve në sektorin e Ujësllës Kanalizime
<b>Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen</b>	<p>Ky program investimesh madhore në Bashkinë e Shkodrës synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritjen e qëndrueshmërisë së shërbimeve bashkiake në sektorin e ujësjellës dhe kanalizime.</li> <li>• Mbulimin e plotë të shpenzimeve operative me të ardhurat e shoqërisë Ujësllës Kanalizime Shkodër.</li> <li>• Përmirësimi dhe përballueshmëria e aksesit në furnizimin e sigurt me ujë të pijshëm, në përputhje me direktivat e BE-së.</li> </ul>

### 0.3. Kostot e Projektit të Investimit

Financimi i këtij programi investimesh, bëhet në bashkëpunim mes Qeverisë Gjermane dhe Zvicerane, si dhe Bashkimit European.

**Institucioni zbatues:** UK Shkodër sh.a

**Institucioni Likuidues:** Ministria e Financave e Shqipërisë

### 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
<b>Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)</b>				
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)</b>				
<b>Sekretari i Përgjithshem</b>				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë
<b>Komente nga Sekretari i Pergjithshëm (nqs ka)</b>				

**P06370.Q2.O1.A3**

Rikonstruksion e rrjetit kryesor të ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re (faza e dytë dhe e tretë)

**01. Personat e Kontaktit**

<b>Emri i propozuesit të projektit</b>	Bashkia e Shkodrës	<b>Firma e propozuesit të Projektit</b>	
<b>Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve		
<b>Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia Shkodrës	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia Shkodër Njësia Administrative Rrethina

**02. Identifikimi i Idesë së Investimit**

<b>Projekt Idea</b>	Rikonstruksion i rrjetit kryesor të ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re, dhe ndërtim i stacionit të ri të pompimit depoz se re punime elektrike në stacionin e ri.	Viti 2018 e në vazhdim												
<b>Problemet për tu adresuar</b>	Ky rikonstruksion konsiston në ndërhyrjen në riparim dhe venien në funksion të tubacionit kryesor të linjes së ujësjellësit nga depo në shatin Kullaj deri në fshatrat Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), ndërtimin e një depo të re pranë stacionit të pompimit, vendosjen e efëncence të dy puseve të reja në Kullaj, vendosjen e dy pompave zhytëse, vendosjen e një pompe të re për dërgimin e ujit nga depo në stacionin e pompimit deri në depon 1000m <sup>3</sup> dhe 200m <sup>3</sup> në Kullaj. Përfutjesit e këtij investimi janë rreth 16000 banorë të këtyre fshatrave.													
<b>Emri i Programit</b>	Furnizimi me ujë													
<b>Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen</b>	<p>Qëllimi i projektit konsiston në furnizimin me ujë të një zone me mbi 16000 banorë. Rritjen e sigurisë për cilësinë e furnizimit me ujë të popullatës dhe administrimin me të mirë të burimeve ujore të zonës.</p> <p>Me zbatimin e këtij projekti do të përfitohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Depo e re pranë stacionit të pompimit</li> <li>• Dhoma e klorinimit</li> <li>• Stacion pompimi</li> <li>• Linja stacion pompimi deri në depon 1000m<sup>3</sup> ekzistuese</li> <li>• Punimet elektrike për stacionin e ri të pompimit</li> <li>• Linjat shpërndarëse për Fshatin e Ri</li> <li>• Riparim pjesor të linjes kryesore</li> <li>• Venien në efëncence të dy puseve të ujit ekzistues</li> <li>• Linjat shpërndarëse për fshatrat Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka</li> <li>• Vendosja e matesave për konsumatorët</li> </ul> <p>Në vitin 2018 Bashkia Shkodër alokoi 65,670 mijë lekë për projektimin dhe fillimin e zbatimit të investimit "Rikonstruksion e rrjetit kryesor të ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re"</p> <table border="1"> <tr> <td></td> <td>Totali i planifikuar për fazën e parë dhe të dytë të projektit viti 2018-2021</td> </tr> <tr> <td>Kosto e zbatimit</td> <td>60,000</td> </tr> <tr> <td>Kosto supervizim</td> <td>1,134</td> </tr> <tr> <td>Kosto kolaudim</td> <td>170</td> </tr> <tr> <td>Kosto e projektimit</td> <td>4,366</td> </tr> <tr> <td>Kosto Totale e Projektit - 000/lekë</td> <td>65,670</td> </tr> </table> <p><b>Në fazën e parë</b> u realizua projektimi. Gjate vitit 2018-2019 u realizua projektimi i kësaj vepre. Vlera e përgjithshme e zbatimit të projektit të investimit është 99,989,520 leke</p> <p><b>Gjate fazës së dytë</b> (2019-2021) të projektit është filluar me zbatimin e punimeve të projektit.</p> <p>Punimet e realizuara gjatë kësaj faze janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi dhe sistemimi i linjes magjistrale të furnizimit me ujë, rreth 10 000 ml linje.</li> </ul>			Totali i planifikuar për fazën e parë dhe të dytë të projektit viti 2018-2021	Kosto e zbatimit	60,000	Kosto supervizim	1,134	Kosto kolaudim	170	Kosto e projektimit	4,366	Kosto Totale e Projektit - 000/lekë	65,670
	Totali i planifikuar për fazën e parë dhe të dytë të projektit viti 2018-2021													
Kosto e zbatimit	60,000													
Kosto supervizim	1,134													
Kosto kolaudim	170													
Kosto e projektimit	4,366													
Kosto Totale e Projektit - 000/lekë	65,670													

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndertimi i sistemit te shperndarjes deri tek kufiri i pronës dhe vendosja e matësve dhe rakorderive te nevojshme, per fshatin Guci, Grude dhe nje pjese te Shtojit te vjeter dhe Vinotekes.</li> <li>Deri ne perfundim te kesaj faze jane shtruar rreth 23 000 ml linje shperndarjeje.</li> <li>Jane instaluar rreth 590 matesa uji, per te gjitha pikat e lidhjes se lena per klientet.</li> <li>Gjate kesaj faze është krijuar mundësia për lidhjen me rrjetin e furnizimit për rreth 4 000 banorë.</li> <li>Kanë përfunduar të gjitha punimet tek stacioni i pompimit dhe depot e ujit të pijshëm. Brenda vitit 2021 kryhet montimi i dy pompave zhytëse 25 l/s dhe dy pompave shtytëse.</li> <li>Janë ndertuar dy puse, kaptazhe..</li> <li>Është ndërtuar një rezervuar i ndërmjetem me kapacitet 200 m3, i cili ka edhe njesinë e klorinimit.</li> <li>Është ndërtuar rezervuari që bën shpërndarjen e ujit tek fshatrat, me kapacitet 1000 m3.</li> <li>Është ndërtuar kabina elektrike e kompletuar me kabinë të komandimit dhe transformator.</li> <li>Është ndertuar linja e furnizimit me energji elektrike, rreth 900 ml linjë që lidh edhe kaptazhet me energji elektrike.</li> </ul> <p><b>Faza e trete dhe e katërt</b> e këtij projekti (2022-gjysma e parë e vitit 2023) konsiston ne realizimin e punimeve për zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes dhe konkretisht;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i sistemit të shpërndarjes deri tek kufiri i pronës dhe vendosja e matësve dhe rakorderive të nevojshme për pjesën e mbetur të fshatit Shtoj i vjetër dhe Vinoteka.</li> <li>Ndërtimi i sistemit të shpërndarjes deri tek kufiri i pronës dhe vendosja e matësve dhe rakorderive të nevojshme për fshatin Shtoj i ri, Hot i ri, Guci e re dhe Fshati i ri (Pularia).</li> <li>Riparimi i të gjithë rrjetit ekzistues të ujësjellësit, aktualisht jo funksional, vendosja e matësve dhe rakorderife, furnizimi me ujë për fshatin Grudë.</li> <li>Gjatë kesaj faze parashikohet të ndertohen rreth 20 000 ml linjë kryesore për furnizimin me ujë të fshatrave të tjerë, si dhe rreth 60 000 ml linjë e rrjetit shpërndarës.</li> <li>Gjithashtu gjatë kësaj faze do të instalohen edhe rreth 2300 matësja uji, në pikat e lidhjes.</li> </ul> <p>Me finalizimin e kesaj faze pritet që t'u mundësohet lidhja me rrjetin e furnizimit me ujë edhe rreth 12 mijë banorëve të tjerë.</p>
<b>Problemet e ndeshura gjate zbatimit</b>	Faza e dytë e projektit si rrjedhoje e pengesave të krijuara nga problem në lidhje me pronësinë e truallit ku do të ndertohet vepra e depos, si dhe nga pandemia Covid 19, rezultoi ne vonesa në perfundim e saj dhe nevojën për shtyrjen e afatit të perfundimit të punimeve të parashikuara për këtë fazë deri në fund të vitit 2021.

### 0.3. Kostot e Projektit të Investimit

	Faza e I-re Realizuar 2018	Faza e II-te Perfundon 2021	Faza e III-te 2022	Faza e III-te 2023	Totali
<b>Kosto e zbatimit</b>	8,925,814	47,011,350	22,026,178	22,026,178	<b>99,989,520</b>
<b>Kosto supervizim</b>	472,500	542,986			<b>1,015,486</b>
<b>Kosto kolaudim</b>	70,875				<b>70,875</b>
<b>Kosto e projektimit</b>	3638250				<b>3,638,250</b>
<b>Kosto Totale e Projektit - 000/lekë</b>	<b>13,107,439</b>	<b>47,554,336</b>	<b>22,026,178</b>	<b>22,026,178</b>	<b>104,714,131</b>
<b>Institucioni zbatues:</b> UK Shkodër sh.a					
<b>Institucioni Likuidues:</b> UK Shkodër sh.a					

### 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
<b>Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)</b>				
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)</b>				
<b>Sekretari i Përgjithshem</b>				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë

Komente nga Sekretari i Pergjithshëm (nqs ka)